



Republika e Kosovës  
Republika Kosova–Republic of Kosovo  
Komuna e Drenasit  
Opština Drenas–Municipality of Drenas



|                                                              |         |           |           |
|--------------------------------------------------------------|---------|-----------|-----------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS<br>KOMUNA GLLOGOC<br>GLOGOC MUNICIPALITY |         |           |           |
| Pranuar                                                      | 29      | 1         | 12 / 2022 |
| Nj. Org.                                                     | Komëtar | Shërbëtor | Vlera     |
| 01-060101 66712                                              |         |           |           |

# PROCESVERBAL I TUBIMIT PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN NJË VJEÇARE TË VITIT 2022



## KOMUNA E DRENASIT

29/12/2022

## INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Në mbështetje të nenit 68, Kreu i IX- Demokracia e Drejtpërdrejtë dhe Mekanizmat e Pjesëmarrjes së Qytetarëve, pika 68.1, 68.2 dhe 68.3 që ka të bëjë me informimin publik dhe konsultim të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 21, 22, 23, 24, 25 të Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe nenit 7 pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Rregullores për Transparencë në Komuna, NR.03/2019, Kryetari i Komunës është i obliguar që të mbajë së paku dy takime publike me qytetarë. Tubimi i parë publik duhet të mbahet në gjashtë mujorin e parë kurse tubimi i dytë publik duhet të mbahet në gjashtë mujorin e dytë të vitit.

Andaj, bazuar në obligimet ligjore që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullorja për Transparencë në Komuna, kryetari në bashkëpunim me Zyrën për Informim organizon Tubimin e dytë publik për punën njëvjeçare të vitit 2022.

Njoftimi për mbajtjen e tubimit publik, ashtu siç parashihet në Udhëzimin administrativ për standardet minimale të konsultimit publik, u publikua me: 9 dhjetor 2022, 14 ditë para mbajtjes së tubimit publik në ueb-faqen zyrtare të komunës së Drenasit, në Platformën qeveritare për konsultime publike si dhe në rrjetet sociale.

Linku në ueb-faqen e komunës:

<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2022/12/Njoftimi-per-tubim-me-publikun-shqip.pdf>

Linku në rrjetin social facebook:

<https://www.facebook.com/100057638043139/posts/pfbid0mfeRbRBgkXK52pUWgEyjye9JTTKBsDHGH2BPWPPGK2MPKkYFTvH3LrkdLtpVngZ5l/?mibextid=cr9u03>

Të gjithë administratorët e fshatrave dhe lagjeve, drejtorë të shkollave, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe përfaqësues të mediave, janë njoftuar me kohë.

Në këtë tubim publik, në koordinim me kryetarin e komunës kemi caktuar një rend dite, si vijon:

- PREZANTIMI I RAPORTIT NJË VJEÇAR I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS
- INFORMIM RRETH PROJEKTEVE DHE AKTIVITETEVE NË KOMUNËN E DRENASIT
- PYETJE DHE PËRGJIGJE

Sipas nenit 10, pika 7 e Rregullores për Transparencë në Komuna, nëse parashtrohet ndonjë pyetje për të cilën nuk mund të jepet përgjigje menjëherë, parashtruesi ka të drejtë të kërkojë përgjigje me shkrim brenda 30 ditësh pas mbajtjes së tubimit.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna e Drenasit**  
Zyra e Kryetarit

|                   |    |    |      |
|-------------------|----|----|------|
| KOMUNA E DRENASIT |    |    |      |
| MUNICIPALITY      |    |    |      |
| anuar             | 09 | 12 | 2022 |
| Nj. Org.          | në |    | Vite |
| 01. 060. 63416    |    |    |      |



Në vështrim të nenit 68, Kreu i IX- Demokracia e Drejtpërdrejtë dhe Mekanizmat e Pjesëmarrjes së Qytetarëve, pika 68.1, 68.2 dhe 68.3 që ka të bëjë me informimin publik dhe konsultim të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 21, 22, 23, 24, 25 të Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe nenit 7 pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Rregullores Komunale për Transparencë, Komuna e Drenasit:

## **ORGANIZON**

### **Tubim me publikun**

**Të premten** më datën **23.12.2022** duke filluar në orën **14:00**.

Tubimi me publikun do të mbahet në **Sallën e Kuvendit** dhe ftohen të gjithë qytetarët apo subjektet e interesuara të Komunës të marrin pjesë në këtë Tubim publik duke ju përmbytur terminin të caktuar më lart.

Në këtë Tubim me publikun përfaqësuesit e Komunës do të informojnë pjesëmarrësit për aktivitetin e Komunës gjatë këtij viti, për të arriturat, vështirësitë dhe synimet, si dhe investimet kapitale, ndërsa pjesëmarrësit mund t'u shtrojnë pyetje dhe të japin propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal, lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara gjatë vitit 2022 dhe çështje tjera në interes të qytetarëve të Komunës.

Me respekt!

**KRYETARI I KOMUNËS**  
  
**Ramiz Lladrovci**

## TUBIMI PUBLIK

Ashtu edhe siç ishte paralajmëruar sipas njoftimit, tubimi publik filloi në ora 14:00.

Tubimi u mbajt në Sallën e Kuvendit ku të pranishëm në këtë takim ishin: Ramiz Lladrovci, kryetar i Komunës, nënkryetari i Komunës, Arben Shala, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë komunal, administratorë të fshatrave dhe lagjeve të qytetit të Drenasit si dhe qytetarë të shumtë.

Fillimisht, fjalë hyrëse pati **Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra**, i cili tregoi rëndësinë e këtij takimi duke shtuar:



I nderuari kryetari i Komunës, z. Ramiz Lladrovci, drejtor të drejtorive komunale, anëtar të Kuvendit të Komunës, administrator të fshatrave, përfaqësues të lagjeve, organizatave jo qeveritare, ju qytetarë.

Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje Lokale, Komuna është e obliguar të mbaj dy tubime me publikun, njërin pas përfundimit të gjashtëmujorit të parë, të vitit fiskal dhe tjetri në fundvit, këtë që sot po e mbajmë.

Për këtë tubim, Komuna ka bërë me kohë njoftimin dhe ka publikuar dy javë para në ueb-faqe të Komunës, në rrjetin social të Komunës, njoftimi është vendosur edhe në dy hyrjet e objektit të Komunës, është vendosur edhe në vendet më të frekuentuara si dhe në mediat online. Po ashtu janë kontaktuar të gjithë administratorët e fshatrave.

Të nderuar të pranishëm,

Ndjej për obligim të ju njoftoj për rregullat e takimit!

Tubimi me publikun ka karakterin informues për pjesëmarrësit, ku përfaqësuesit e Komunës njoftojnë për aktivitetet e Komunës gjatë këtij viti, për të arriturat dhe vështirësitë, për synimet si dhe investimet kapitale, ndërsa ju të pranishëm, mund të shtroni pyetje dhe të jepni propozime e sugjerime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara për vitin dhe çështje të tjera që janë në interes të qytetarëve.

Ftoj, Kryetarin e Komunës, z. Ramiz Lladrovci të përshëndet takimin dhe në pika të shkurtra, të prezantoj aktivitetet e komunës gjatë këtij viti, për sukseset dhe sfidat.

## **Kryetari, Ramiz Lladrovci:**

Të nderuar qytetarë të Drenasit, zonja e zotërinj, administratorë të vendbanimeve, ju faleminderit për praninë Tuaj.

Ky takim me juve, është tubim përmbyllës për këtë vit, ku në pika të shkurtra do të flas për punën tonë, për arritjet tona në vitin 2022.



Ju falënderoj për praninë Tuaj, njëherësh i falënderoj qytetarët, të cilët na kanë mirëkuptuar e bashkëpunuar në arritjen e qëllimeve tona të përbashkëta.

Falënderoj në veçanti administratorët e vendbanimeve që pa kursyer kohën e tyre, kanë bashkëpunuar me ekzekutivin për t'ju dal në ndihmë qytetarëve, projekteve të nivelit qendror e lokal, me propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet gjatë tërë vitit.

Ky vit, po përmbyllet me suksese. Këto suksese presim të konfirmojnë edhe zyrtarisht se jemi komuna më e mirë me performancë në nivel të Republikës. Presim grantin për vendin e parë, normalisht.

## **Shërbimet publike dhe emergjencë:**

Rregullimi i rrethojave të varrezave në Komunën e Drenasit;  
Rregullimi i parkingut për autotaksi;  
Riparimi dhe zgjerimi i vendndaljeve për autobus dhe mbulimi i tyre;  
Zgjerimi dhe mirëmbajtja e kamerave në komunën e Drenasit;  
Mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit Publik;  
Blerja e kontejnerëve dhe shportave për mbeturina;  
Blerja dhe furnizimi me Ulëse dhe shporta për shesh dhe parqe;  
Shenjëzimi Vertikal dhe Horizontal i rrugëve (Kontratë Kornizë);  
Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit dimëror e veror për vitin 2021- 2022.

Jemi në proces të themelimit të kompanisë lokale që do të merret me mbeturina.  
Mirëmbajtja e kanalizimeve fekale dhe atmosferike dhe gropave septike (kontratë kornizë);  
Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katërt me zhavorr;  
Mirëmbajtja e parqeve dhe gjelbërimi i qytetit të Drenasi (kontratë kornizë);  
Projekti i eliminimit të deponive ilegale, dhe Projekti për mirëmbajtjen e deponisë inerte në Llapushnik;  
Projekti për Shërbimet e varrimit për qytetarët e Komunës së Drenasit;  
Eficienca e Energjisë;  
Trajtimi i qenve endacak në komunën e Drenasit;

## **Sa i takon Arsimit,**

Pjesëmarrja në konferencën e dytë kombëtare "Arsimi parauniversitar: Menaxhimi dhe perspektivat në nivel komunal" dhe Prezantimi i projektit "Avancimi i përshpejtuar i cilësisë në arsim, shkëmbimi i përvojave me vendet e BE-së", projekt ky i pari në nivel vendi për nga mënyra e implementimit.

Nxënësit e Gjimnazit "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" me pjesëmarrje në gara kombëtare dhe ndërkombëtare (Gara ndërkombëtare në Schwäbig-Gmünd të Gjermanisë inovacion dhe teknologji Gara dhe projekte të përbashkëta me disa gjimnaze nga Kosova, Finlanda e Gjermania, Vlerësime të larta nga organizatorët dhe mësimdhënësit nga konferenca, seminare e punëtori ndërkombëtare, Rezultate të larta në seminare dhe konferenca ndërkombëtare).

Sipas vlerësimit nga zyra e BE-së për arsim në Kosovë, DKA e Drenasit i prin të gjitha DKA-ve të Kosovës për respektimin, praktikimin e të gjitha rregulloreve, udhëzimeve dhe akteve tjera nënligjore si dhe për përdorimin e mekanizmave dhe strategjive për ngritjen e cilësisë në arsim.

## **Gjatë periudhës së viti 2022 kemi realizuar një numër të madh të projekteve të infrastrukturës**

Ndërtimi dhe rehabilitimi i kanalizimit primar dhe sekondar në Drenas dhe fshatra përreth janë realizuar rreth 15.000 metra me diametër të gypit fi 250 dhe fi 315 të cilët shërbejnë për lidhje primare dhe sekondare në lagje të ndryshme në komunën tonë ndërsa në proces janë edhe 3.000 metra tjera.

Ndërtimi i kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza kanë përfunduar rreth 7.000 metra nga gjimnazi në drejtim të Dobroshecit.

Urat dhe tombinat kanë përfunduar ura në Poklek të Vjetër dhe Dobroshec, lagjen Hajdari është realizuar ajo në lagjen Avdyli në proces janë edhe 3 tombina dhe një vig për këmbësor në Poklek të Vjetër.

Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrugës "Besim Mala" janë duke u zhvilluar punimet në zgjerimin e rrugës në 3 korsi ku në projekt është edhe trotuari dhe shiriti për biçikletë.

Infrastruktura në Drenas në të cilën kemi paraparë rregullimin dhe asfaltimin e parkingut të Hekurudha i cili do të shërbejë për 350 parkingje si dhe rregullimi i shtigjeve për biçikleta, punimet janë duke u zhvilluar dhe në vitin e ardhshëm do të asfaltohet.

### Asfaltimi i segmenteve rrugore:

Tërdec janë asfaltuar 8 segmente rrugore edhe në proces janë edhe 5 segmente tjera, dhe është asfaltuar rruga Tërdec-Vuqak.

Gllanasellë, janë asfaltuar 10 segmente rrugore në proces janë edhe 4 segmente.

Dobroshec, janë duke u zhvilluar punimet në ndërtimin e bazamenteve rrugore në 8 segmente dhe 15 tjera janë në proces

Në zonën e Komaranit me fshatrat përreth janë duke u realizuar 45 segmente rrugore një pjesë e tyre kanë përfunduar edhe me asfaltim ndërsa një pjesë në ndërtimin e bazamentit për asfaltim.

Në zonën e Terstenikut me fshatrat përreth janë në proces 30 segmente rrugore dhe pritet të fillojnë me realizimin e bazamentit për asfaltim.

Në shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit jemi duke punuar në pastrimin edhe izolimin e rezervarit në Kamenicë ku shpresojmë që shumë shpejt do të lëshohet uji i pijes në drejtim të Terstenikut dhe Gllanasellës me fshatrat përreth, gjithmonë nëse ekziston infrastruktura e rrjetit.

### Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit

Miratimi i Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën 2022-2028, në kuvendin e komunës në të cilën do të nisin ndërtimet e mesme dhe të larta në Komunën e Drenasit.

Kompletimi i legjislacionit në fushën e planifikimit hapësinor, me miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028, Hartën Zonale të Komunës së Glllogocit 2022-2030 dhe Planet Rregulluese të Hollësishme Urbane.

Gjelbërimi dhe shtimin e hapësirave publike të gjelbra.

Rritjen e të hyrave vetanake në sektorin e ndërtimit.

### Raporti i sotëm i Buxhetit, tregon këto shifra:

| Kategoritë                 | Buxheti       | Shpenzimi            | Përqindja    |
|----------------------------|---------------|----------------------|--------------|
| Pagat                      | 8,997,131.12  | 8,976,925.86         | 99.78        |
| Mallra e shërbime          | 2,524,342.10  | 1,956,591.36         | 77.51        |
| Komunali                   | 298,508.00    | 275,282.65           | 92.22        |
| Subvencione trans          | 466,857.50    | 413,003.69           | 88.46        |
| Kapitale                   | 5,416,656.91  | 4,888,083.55         | 90.24        |
| Totali                     | 17,815,370.91 | 16,509,887.11        | 92.67        |
| Pagat për muajin 12        |               | 816,084.17           |              |
| <b>Totali i shpenzimit</b> |               | <b>17,325,971.28</b> | <b>97.25</b> |

Një raport të përmbledhur të të gjitha drejtorive, me 24 faqe, kushdo që është i interesuar për detaje, mund të ketë qasje.

Njëherësh, para jush dua të shpalosi po ashtu edhe dy projekte të cilat synohen të realizohen së shpejti: Projekti i objektit me hapësira komunale në vend të objektit të komunës së vjetër si dhe ndërtimi i sheshit të qytetit. Projekte këto madhore, të cilat do të jenë në dobi dhe shërbim të qytetarëve.

Faleminderit.

### **Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra:**

Ju faleminderit kryetar, të nderuar të pranishëm tani fjala është për ju, por paraprakisht kur të merrni fjalën, të prezantoheni për arsye të regjistrimeve dhe mbajtjes së procesit për t'i adresuar kërkesat, apo sugjerimet tuaja.

Fjala është për ju.

### **Izet Bytyçi- Përfaqësues i fshatit Fushticë e Epërme**

E falënderoj kryetarin e komunës që na rrëfej për këto të arritura gjatë këtij viti. Unë mendoj që investimet në terren të bëhen në përpjesëtim të plot, e jo në një fshat ose në një lokalitet më shumë e diku zero. Nuk them që nuk është punuar asgjë, por në lokalitetin tim edhe pse kam bërë kërkesë për ndriçim, nuk është realizuar një kërkesë e tillë. Po ashtu kam bërë kërkesë për përfshirjen e 8 familjeve në sistemin e kanalizimit pasi që ato janë jashtë këtij sistemi, as edhe kjo kërkesë nuk është shqyrtuar. Ka një investim madhor në lokalitetin tim, diku 2 milion e 5 mijë euro është ndërtuar një shkollë e cila është ende jo funksionale si dhe nuk ka as çati dhe e njëjta është duke e u shkatërruar. Andaj, do të ishte mirë që kjo shkollë të rehabilitohej. Kaq nga unë, faleminderit.

### **Kryetari Lladrovci**

I nderuari Izet, informata se investimet diku janë bërë shumë e diku zero, nuk qëndron dhe nuk janë reale fare. Investimi ynë ka qenë përafërsisht i njëjtë. Sa i përket ndriçimit, siç e kam cekë edhe herëve tjera; aty ku nuk ka shtylla betoni nuk mund te behet ndriçimi pasi që nuk mund te behet investim i dyfishtë. Pra derisa te rregullohen shtyllat e betonit përgjatë rrugëve nëpër lagje. Sa i përket kërkesave, Izet, ju e dini se dhe po e rikujtoj prapë se, kërkesat i marri gjatë dëgjimeve buxhetore në qershor dhe korrik mandej vendos kuvendi dhe ndahet buxheti. Ju mund te bëni kërkesa edhe pas ndarjes se buxhetit, porse janë të pa realizuara, pasi që nuk mund të ndërhyjmë pasi të është caktuar buxheti. Andaj ju ftoj që kërkesat t'i adresoni në muajin qershor apo korrik në mënyrë që ato të procedohet tutje.

Faleminderit.

### **Habib Mulaj-qytetar nga Drenasi**

Së pari desha t'ju përshëndes të gjithëve dhe desha t'ju bëjë disa pyetje rreth qendrës së qytetit. Unë jam i lindur dhe i rritur në qendër të Drenasit, dhe mund të them që e përgëzoj këtë qeverisje që këtë vit po bën disa investime që janë për tu vlerësuar. Normalisht që duhet me shume te behet, kur dihet se ne zonën ku unë banoj thuaja ndriçimi është zero. E njëjta vlen edhe për disa trotuare, ku gjendja e tyre është e mjerueshme.

Sa i përket projekteve që u përmendën, unë jam tej mase i kënaqur që hapësira të tilla do të ndërtohen. Mbase një projekt më i detajuar do të duhej të behej në mënyrë që të jemi sa më të informuar përreth këtyre projekteve.

Edhe njëherë ju përgëzoj për punën që keni bërë deri më tani, kryetar.

Faleminderit.

### **Kryetari Lladrovci**

Habib, së pari të falënderoj për pyetjet. Edhe në të kaluarën është punuar në disa projekte që janë projekte nëntokësore si: rregullimi i ujësjellësit, kanalizimit etj., edhe tash po punohet. Sa i përket ndriçimit, jemi duke punuar në atë drejtim. Ndërsa për trotuaret që tashmë janë, jemi duke i mirëmbajtur si duhet. Ndërsa trotuare tjera priten të ndërtohen.

Në lidhje me projektet; ju e dini se këto projekte janë projekte ideore dhe se punimi i projekteve në detaje ka një kosto të lartë. Unë, do mundohem që me ndihmën e donatoreve, pra duke kursyer paranë e qytetarëve, projektin e sheshit do ta hartojmë në mënyrë të detajuar. Sa i përket projektit për objektin në vend të ndërtesës së komunës së vjetër, është një projekt ideor dhe se ndër kriteret i aplikimit ka qenë që kompania duhet të sjell edhe projektin ideor. Në momentin e shpalljes së fituesit, kompania fituese do ta paraqesë projektin final në mënyrë të detajuar.

Në lidhje me parkingun i cili ndodhet në qytet, afër hekurudhës. Ju e dini që unë i paguaj qira mujore hekurudhave të Kosovës për parkingun i cili është duke marr pamjen e vet. Parking ky i cili është në shfrytëzim të qytetareve.

Faleminderit.

### **Fadil Tiku- Administrator i Fshatit Vërboc**

Me 13.01.2022, unë kam dorëzuar 8 kërkesa për fshatin Vërboc dhe asnjë nga to nuk më është shqyrtuar. Po ashtu kam një ankesë nga banorët e fshatit Vërboc, për qendrën e mjekësisë familjare në fshatin Tërstenik ku mungon stafi tekniko-shërbyes dhe në mungesë të tyre, nuk ka ngrohje. Çështja tjetër që dua të ngriti ka të bëjë me fëmijët/familjaret e dëshmorëve, të cilëve u vjen vërejtja edhe nga përmbaruesi për mos kryerjen e pagesës së tatimit në pronë. Pra desha të di se si qëndron çështja e fëmijëve të dëshmorëve, kanë obligime të tatimit në pronë apo nuk kanë.

### **Kryetari Lladrovci**

Sa i përket kërkesave të dorëzuara, unë e ceka edhe më herët kohën kur kërkesat shqyrtohen. Andaj lus që të shfrytëzoni ato afate kohore, në mënyrë që të shqyrtohen kërkesat në kohë. Komuna ka kontraktuar kompani të pastrimit për QMF-të. Sa i përket tatimit në pronë, duhet ta keni të qartë se asnjë person juridiko-fizik nuk lirohet nga tatimi në pronë. Mbi të gjitha, tatimi në pronë përcaktohet nga niveli qendror, jo nga komuna.

### **Bajram Qallapeku-Administrator i fshatit Terstenik II**

Fillimisht ju përsëndes, dhe desha të shtoj se disa rrugë, si rruga e Bazajve dhe rruga tjetër tek përmendorja si dhe disa kanalizime janë ende pa u përfunduar. Ujësjiellësi mungon në Tërstenikun II edhe pse jemi afër Tërstenikut I, i cili tashmë ka ujësjiellësin që tash e 15 vite. Andaj, a mund të na tregoni një datë se kur pritet të lidhemi me ujësjiellës.

Faleminderit dhe të përgëzoj për projektet të cilat na i prezantove.

### **Kryetari Lladrovci**

Faleminderit Bajram, projektet që kanë mbet të pa realizuara në atë zonë, edhe ato do të përfundojnë së shpejti. Sa i përket ujësjiellësit, ju e dini se gypi kryesor që furnizon me ujë është i dëmtuar nga kompania e cila ka asfaltuar rrugën me 4 korsë. Andaj, kompania e ujësjiellësit është ajo e cila është dashur të punoj në sanimin e dëmit. Siç e di edhe ti, shtrirja e gypit të ujësjiellësit është donacion nga organizata gjermane CDI nën mbikëqyrjen e kompanisë së ujësjiellësit. Mbi të gjitha, po shpresoj se gjatë stinës së pranverës do të realizohet edhe ai projekt.

### **Kadri Ajazi-Administrator i fshatit Sankoc**

I nderuari kryetar, të nderuar të pranishëm,

Unë ju përgëzoj për punët që keni bërë dhe vazhdoni ti bëni, e në veçanti ju falënderoj për prezantimin e projektit që do të zhvillohet në vend të komunës së vjetër.

Sa i përket punimeve që janë kryer në fshatin tim e që janë të shumta, të jemi falënderues. Sanimi i ujërave të zeza, pra shtrirja e mbi 1000metra kanalizim. Mandej rrethoja në lagjen Gjoshi, e shumë gjëra tjera, me të vërtet janë për tu lavdëruar. Për vitin e ardhshëm sigurisht që kemi edhe disa rrugica që duhen shtruar, trotuare të rregullohen, e po ashtu edhe disa metra tjerë kanalizim që jam i sigurt se edhe ato do të kryhen. Edhe një gjë është shqetësuese, kompania e Pastrimit nuk është duke i kryer obligimet si duhet. Ka më shumë se 15 shtëpi që duhet ti bartin kontejnerët e bërrilokut me metra të tërë pasi që kompania në fjalë nuk vije t'i marr siç e thotë edhe marrëveshja e nënshkruar.

Faleminderit.

### **Kryetari Lladrovci**

Faleminderit Kadri.

Ti e di fare mirë që kemi premtuar se të gjitha pronat dhe fushat e fshatit Sankoc do t'i fusim në hartën zonale për zhvillim ekonomik, dhe pres edhe nga ju që të bëni përpjekje për të gjetur donator në mënyrë që ta qojmë zhvillimin përpara. Rrugët, kanalizimet e të gjitha këto do ti përfundojmë ashtu siç edhe i kemi në plan. Sa i përket bërllokut, jemi duke u munduar të përgjigjemi në çdo kërkesë, andaj edhe jemi duke bërë përpjekje për ta krijuar një kompani lokale të pastrimit ku edhe besojmë që do të jemi akoma më mirë në largimin e mbeturinave.

Faleminderit.

### **Zekë Kluna-Administrator i fshatit Poklek i Vjetër**

Unë ju falënderoj për punën që keni bërë dhe po bëni, njëherësh kam edhe një vërejtje për drejtorinë e infrastrukturës e cila ka premtuar ta largoj gropën septike tek uji i thartë si dhe shtrimin e disa rrugëve por që nuk janë realizuar.

Faleminderit.

### **Kryetari Lladrovci**

Zekë, faleminderit dhe duhet edhe të na kuptoni edhe ju që për dy vite ishim në pandemi, mandej edhe OSHP-ia (Organi Shqyrtues i Prokurimit) nuk ka punuar pothuajse për një vit dhe, edhe krahas kësaj kemi bërë punë të shkëlqyer. Andaj edhe ato dy rrugica që përmende do të asfaltohen. Faleminderit.

### **Samedin Kiçina-Administrator i fshatit Baicë**

Nuk mund të themi që nuk është punuar asgjë, ka gjëra që janë punuar edhe pse me vonesë. Është bërë rrethoja e varrezave e shumëçka tjetër. Disa rrugica nuk janë shtruar ende. Po ashtu edhe ndriçimi nuk është kryer ende dhe nuk e di përse. Është urgjente që nga vendkalimi i hekurudhës e deri tek shkolla të bëhet ndriçimi andaj lus dhe po shpresoj që ta bëni. Në fshatin Baicë është një familje skamnore prej 7 anëtarësh e cila jeton në kushte të mjerueshme, andaj lus që po patët mundësi qoftë përmes ndonjë shoqate humanitare apo disi, t'i ndihmojmë kësaj familje. Faleminderit.

### **Kryetari Lladrovci**

Edhe ju e di që shumëçka është punuar në fshatin Baicë edhe do të punohet patjetër. Sa i përket familjes skamnore, ne si komunë së bashku me Jetimat e Ballkani në krye me Halil Kastratin kemi ndërtuar shumë shtëpi për të pastrehët dhe skamnorët në komunën tonë. Dihet që komuna ka participuar në këto shtëpi me 25% të vlerës së kontratës. Sa i përket familjes në fjalë; kjo familje duhet që së pari të paraqitet tek komisioni në komunë në mënyrë që ti plotësoj kriteret dhe t'i ndjek procedurat, dhe besoj që edhe ajo çështje do të kryhet.

### **Ramadan Ramaj-Administrator i fshatit Tërdec**

Se pari ju përshëndes dhe u jam mirënjohës për punën që keni bërë, sidomos në fshatin tonë Tërdec ku 90% e punëve janë kryer tashmë. Kërkesë e banorëve të këtij fshati është largimi i pengesave (policëve të shtrirë) nëpër rrugët e fshatit pasi ato po paraqesin pengesë si për banorët ashtu edhe për veturat po ashtu. Dhe për fund, nëse është e mundur ta kemi një fushë sportive në fshat. Faleminderit.

### **Kryetari Lladrovci**

Faleminderit Ramadan. Sa i përket pengesave në rrugë, komuna tashmë ka lidhur kontratë me një kompani dhe se të gjitha pengesat nëpër rrugët e komunës sonë, që janë vendosur pa miratimin e komisioneve përkatëse komunale do të largohen. Përfundim do të ketë vetëm afër shkollave. Sa i përket fushës së sportit, ajo do të realizohet pasi që një e tillë është e përfshirë në planet tona të ardhshme.

Faleminderit.

### **Hamide Gashi-afariste**

Kam ardhur këtu të ju falënderoj që ju si komune më keni përkrahur në hapjen e biznesit tim si rrobaqepëse. Pra, faleminderit që po mbështesni gratë në biznes, si dhe njëherësh ju bëj thirrje që të vazhdoni t'i përkrahni gratë edhe në të ardhmen.

Faleminderit.

### **Kryetari Lladrovci**

Faleminderit shumë zonjë. Neve e kemi obligim që ti mbështesim gratë dhe do vazhdojmë të i mbështesim edhe akoma me shumë.

Faleminderit.

Nëse nuk ka më pyetje, unë dua të ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj, për sugjerimet që keni dhënë dhe pyetjet që keni parashtruar. Njëherësh, ju roj festat e fundvitit duke ju dëshiruar fat e suksese me njerëzit dhe familjet tuaja, si dhe të jemi bashkë për të mirën e Drenasit.

Faleminderit.









Kryetari i Komunës së Drenasit

Ramiz Lladrovci



Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave

Artan Hasani